



AGJENCIA E MBËSHTETJES FINANCIARE TË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në mbështetje të nenit 7, alineja 9 e Ligjit mbi themelimin e Agjencisë së mbështetjes financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.72/07 dhe 5/09), Agjencia e mbështetjes financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural lëshon si më poshtë

SHPALLJE PUBLIKE nr.01/2014 Për parashtrimin e kërkesave për përdorimin e mjeteve financiare të Programit për mbështetjen financiare të zhvillimit rural për vitin 2014

I. OBJEKTI I SHPALLJES

Objekti i kësaj shpalljeje është dhënia e asistencës financiare për masat në vijim:

Grupi i masave	Emri i masës
1	Mbështetje teknike të bujqësisë dhe zhvillimit rural
1.4	Ndihmë në fushën e marketingut për produktet bujqësore dhe produktet e përpunuara bujqësore <ul style="list-style-type: none">Hapja dhe funksionimi i shitoreve të specializuara dhe të unifikuara për shitjen e verës së prodhuar në Republikën e Maqedonisë.

II. E DREJTA E PËRDORIMIT TË MJETEVE

Të drejtë për t'i përdorur mjetet kanë subjektet në vijim:

- Subjektet juridike që janë regjistruar në përputhje me Ligjin mbi shoqëritë tregtare dhe Ligjin e hotelerisë dhe që plotësojnë kushtet e parapara me Ligjin e tregtisë.

III. SHUMA E MBËSHTETJES FINANCIARE

Mjetet janë paraparë për investime lidhur me hapjen dhe funksionimin e shitoreve të specializuara dhe të unifikuara për shitjen e verës së prodhuar në Republikën e Maqedonisë, si më poshtë: në Shkup dy shitore, në Ohër, Berovë, Kavadar, Shtip, Strumicë, Prilep, Manastir dhe Krushevë nga një shitore.

Mbështetja financiare do të mundësohet sipas parimit të ko-financimit të investimeve të përfunduara dhe të paguara nga ana e përdoruesit, në shumë prej:

- 50% të shpenzimeve për kompletimin e shitores, me përjashtim të investimeve për ambiente ndihmëse dhe sanitare, por jo më shumë se 1.000.000 denarë.
- 50% të shumës së qirasë vjetore, por jo më shumë se 30.000 denarë në muaj.
- Jo më shumë se dy rroga mesatare të veprimtarisë përkatëse për dy persona të punësuar për shitjen e verës në shitoret përkatëse.

Ndihma financiare nuk duhet kthyer.

IV. KUSHTET E PËRDORIMIT TË NDIHMËS DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

Kërkesa duhet parashtruar me një kopje origjinale.

Një kërkesë mund të parashtrorë kërkesë vetëm për një masë. Një kërkesë nuk mund të parashtrorë më shumë se 2 kërkesa të veçanta për masa të veçanta, duke i pasur parasysh edhe masat e tjera të Programit për zhvillim rural për vitin 2014.

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kërkesit e mjeteve janë paraparë me:

- Programin e mbështetjes financiare të zhvillimit rural për vitin 2014 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 10/2014),
- Ligjin e bujqësisë dhe zhvillimit rural („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 49/2010, 53/2011, 126/2012, 15/2013, 69/2013 dhe 106/2013),
- Rregulloren mbi llojin e aktiviteteve, shumën maksimale për një aktivitet, përdoruesit, subjektet që marrin pjesë në procedura, kriteret më të ngushta dhe mënyrën e ndarjes

së ndihmës financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 06/2013, 81/2013, 181/2013 dhe 01/2014)

Kërkesit që do t'i plotësojnë kushtet e shfrytëzimit të mjeteve për masat 1.4 do të klasifikohen sipas kriterëve të Rregullores mbi llojin e aktiviteteve, shumën maksimale për një aktivitet, përdoruesit, subjektet që marrin pjesë në procedura, kriteret më të ngushta dhe mënyrën e ndarjes së ndihmës financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Kërkesat me një numër pikësh do të klasifikohen sipas datës dhe kohës së parashtrimit të tyre.

Kërkesit nuk duhet të fillojnë realizimin e investimit para nënshkrimit të Marrëveshjes së ko-financimit me Agjencinë.

Përdoruesit e mjeteve financiare duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, por edhe detyrimet financiare për vitin 2013 ndaj Ndërmarrjes publike të ekonomizimit të kullotave dhe detyrimet e ujit ndaj ndërmarrjes përkatëse.

V. MARRJA E FORMULARËVE DHE UDHËZIMET

Formulari-Kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve, bashkë me listën e dokumenteve të nevojshme, Udhëzimi i përdoruesve dhe Projekti master me zgjidhje lidhur me enterierin dhe identiteti i brendit mund të gjenden në ueb faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk.

Formularët e mësipërm mund të merren edhe në Agjenci, në adresën:

Agjencia e mbështetjes financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural,
bul. „Brigada e tretë Maqedonase“ nr.20
objekti i Makedonija Tabak, blloku C
1000 Shkup

VI. MËNYRA E PARASHTRIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuara lidhur me shfrytëzimin e mjeteve dhe kërkesat lidhur me pagimin e mjeteve të Programit për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2014, bashkë me dokumentacionin e nevojshëm duhen dorëzuar në gjuhën maqedonase, në zarf të mbyllur në këndin e majtë, në anën e përparme qëndron fjala “MOS E HAP”, për thirrjen publike nr. 01/2014, duke shënuar shifrën e masës për të cilën parashtrorë kërkesa. Kërkesa mund të parashtrorë me postë ose direkt në arkivin e Agjencisë. Në të kundërt Agjencia nuk mban përgjegjësi për mbërritjen e vonuar ose për dokumentacionin e pakompletuar që mund të pranohet në arkiv ose për hapjen e parakohshme të zarfit me kërkesën.

Afati i fundit i dorëzimit të kërkesave është data 01.03.2014. Kërkesat e parashtruara pas kësaj date nuk do të merren parasysh.

Informata më të hollësishme mund të fitoni në numrin (02) 3097-460 ose në emailin: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në ueb faqen: www.ipardpa.gov.mk.

Kontakti:

Agjencia e mbështetjes financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural, Sektori i aprovimit të projekteve.

Telefoni **02 3097 - 460**, çdo ditë pune nga 08.30 deri në orën 16.30

Emaili: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk



AGJENCIA E MBËSHTETJES FINANCIARE TË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL